



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Kodi i lëndës: INF 150

Lënda: Fiziologji

PROGRAMI I LËNDËS									
Fiziologji									
Titullari i lëndës:		Majlinda Zahaj <i>Phd në Shkenca Paraklinike</i> _____							
Ngarkesa:	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
	8 ECTS	Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekte	Total		
	8 ECTS	45	24	4	0	2	75	125	200
Tipologjia e lëndës		Lëndë karakterizuese							
Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti I, Semestri II							
Lloji i lëndës		E detyruar							
Programi i studimit		Bachelor në "Infermieri të Përgjithshme"							
Kodi i lëndës		INF 150							
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës		majlinda.zahaj@univlora.edu.al							

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	
Përshkrimi i lëndës	Është lëndë paraklinike që i pajis studentët me njohuritë e nevojshme për funksionimin normal të organizmit të njeriut, duke filluar nga funksionet e qelizës dhe duke vazhduar me funksionet e çdo sistemi organesh në veçanti.
Objektivat e lëndës	<ul style="list-style-type: none">Njohja me funksionet në nivel qelizor dhe indor.Njohja me funksionet e cdo organi të organizmit të njeriut.Njohja me funksionet dhe kontrollin e cdo sistemi të organizmit të njeriutNjohja me mënyrën e funksionimit të organizmit njerëzor si një i tërë.
Rezultatet e pritshme	Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje: ☞ Të njohin funksionimin normal të organizmit. ☞ Të diferencojnë normalen nga patologjika kur të hyjnë në lëndët klinike

KONCEPTET THEMELORE

- Fiziologjia qelizore dhe specifikat e qelizave të nxitëshme.
- Ndërtimi funksional dhe funksionet specifike të cdo organi dhe sistemi organesh të organizmit të njeriut.
- Rregullimi nervor dhe humoral i veprimtarisë së cdo sistemi të organizmit njerëzor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<p>Tema 1 – Njohja me programin dhe kërkesat e lëndës. <i>Prezantimi ne menyre te detajuar i syllabusit te lendes.</i></p> <p>Tema 2 - Homeostaza <i>Ruajtja e pandryshueshmerisë së mjedisit të brendshëm të organizmit, mekanizmat me të cilët realizohet.</i></p> <p>Tema 3 - Fiziologjia qelizore <i>Ndërtimi dhe funksionet bazë të çdo pjese përberëse të qelizave humane.</i></p> <p>Seminar 1 - 2 – Diskutim mbi objektin e fiziologjisë humane dhe rikujtesë për fiziologjinë qelizore.</p>	<p><i>fq.2-7</i></p> <p><i>fq.7-11</i></p> <p><i>fq.11-21</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 2 orë</p>
II.	<p>Tema 4 – Potenciali membranor <i>Njohja me potencialin membranor të qetësisë dhe veprimit. Faktorët që ndikojnë në secilin prej tyre.</i></p> <p>Tema 5 -Komunikimi ndërqelizor <i>Komunikimi elektrik dhe kimik i dy qelizave me njëra-tjetrën, hallkat që marrin pjesë në këtë komunikim.</i></p> <p>Tema 6 - Organizimi qelizor i indit nervor <i>Ndërtimi funksional i neuronit, tipet dhe funksionet e neurogljas, karakteristikat e përçimit të impulsit në nerv.</i></p> <p>Seminar 3 - 4 – Diskutim mbi potencialin membranor dhe komunikimin qelizor.</p>	<p><i>fq.22-28</i></p> <p><i>fq.28-31</i></p> <p><i>fq.32-35</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 2 orë</p>
III.	<p>Tema 7 – Komunikimi sinaptik <i>Çfarë është sinapsi, pjesët përbërëse të tij, llojet e sinapseve, neurotransmetuesit.</i></p> <p>Tema 8 - Sistemi i përgjithshëm ndijor. Palca e kurrizit <i>Çfarë është ndijimi i përgjithshëm, si transmetohet ai, llojet e receptoreve. Funksionet e palcës së kurrizit.</i></p> <p>Tema 9 - Sistemi i përgjithshëm motor. Sistemi autonom <i>Cilat janë traktet motore (zbritëse), për çfarë përgjigjet secili. Ndarja dhe funksionet e sistemit nervor vegjetativ.</i></p> <p>Seminar 5/6 – Diskutim mbi sistemin nervor perferik dhe sistemin nervor vegjetativ.</p>	<p><i>fq.35-39</i></p> <p><i>fq.39-40, 47-51</i></p> <p><i>fq.51-55</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 2 orë</p>
IV.	<p>Tema 10 - 11 – Ndijimi special <i>Njohja me funksionet e shqisës së dëgjimit, shikimit, nuhatjaes, shijimit. Si perceptohet secili ndijim dhe si kalon dhe perfundon në korteksin cerebral.</i></p> <p>Tema 12 - Strukturat subkortikale <i>Njohja me strukturën dhe funksionet e strukturave subkortikale (bërthamat bazale, talamet, hipotalami, sistemi limbik, truri i vogël, trungu i trurit).</i></p> <p>Seminare 7/8 –Diskutim mbi ndijimin e përgjithshem dhe ndijimin special.</p>	<p><i>fq.40-47</i></p> <p><i>fq.59-62</i></p>	<p>Leksione 2 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminare 2 orë</p>



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
V.	Tema 13 – Korja e trurit <i>Njohja me ncarjen e korteksit në lobet dhe zonat funksionale përkatëse, kontrolli kortikal i të folurit, specializimi i hemisferave, EEG, gjumi.</i>	<i>fq.55-59</i>	Leksion 1 orë
	Tema 14 – Muskujt <i>Njohja me strukturën e muskulaturës së lëmuar dhe vijëzuar, mekanizmi i tkurrjes muskulore, llojet e tkurrjeve.</i>	<i>fq.63-68</i>	Leksion 1 orë
	Tema 15 – Gjaku dhe perberja e tij. Hemostaza. <i>Njohja me përbërjen dhe funksionet e plazmës, eritrociteve, leukociteve, trombociteve. Roli dhe fazat e hemostazës.</i>	<i>fq.69-72</i>	Leksion 1 orë
	Seminare 9 - 10 – Diskutim mbi sistemin nervor qëndror.		<i>Seminare 2 orë</i>
VI.	Tema 16 - 17 – Sistemi imun <i>Njohja me imunitetin e lindur, imunitetin e fituar, grupet e gjakut.</i>	<i>fq.72-76</i>	Leksione 2 orë
	Tema 18 – Zemra dhe qarkullimi i gjakut <i>Anatomia funksionale e zemrës, qarkullimi pulmonar dhe qarkullimi sistematik.</i>	<i>fq.77-79</i>	Leksion 1 orë
	Seminar 11 – Diskutim mbi muskujt Seminar 12 – Diskutim mbi indin e gjakut		<i>Seminare 2 orë</i>
VII.	Tema 19 – Veprimtaria elektrike dhe mekanike e zemrës <i>Njohja me EKG dhe ciklin kardiak, fazat e tij dhe karakteristikat për secilën fazë.</i>	<i>fq.79-82</i>	Leksion 1 orë
	Tema 20 – Kontrolli i veprimtarisë së zemrës. <i>Tonet dhe volumet e zemrës, rregullimi intrinsek dhe ekstrinsek i veprimtarisë së zemrës.</i>	<i>fq.82-85</i>	Leksion 1 orë
	Tema 21 – Sistemi vaskular <i>Konceptet e kthimit venoz, shkëmbimet e lëngut ndërmjet kapilarëve dhe indeve, karakteristikat fizike të enëve të gjakut, rregullimi i punës së enëve të gjakut.</i>	<i>fq.85-89</i>	Leksion 1 orë
	Seminar 13 - 14 – Diskutim mbi sistemin kardio-vaskular.		<i>Seminare 2 orë</i>
VIII.	Tema 22 – Sistemi vaskular <i>Presioni arterial, pulsuar arterial, refleksët e baroreceptoreve dhe të tendosjes atriale.</i>	<i>fq.89-93</i>	Leksion 1 orë
	Tema 23 - 24 – Sistemi Respirator <i>Mekanika e ajrosjes mushkërore, provat funksionale respiratore, shkëmbimi dhe transporti i gazeve, rregullimi i funksionit respirator.</i>	<i>fq.94-105</i>	Leksione 2 orë
	Seminar 15/16 - Diskutim mbi Sistemin Respirator.		<i>Seminare 2 orë</i>
IX.	Tema 25 – 26 - 27 – Sistemi Tretës: <i>Struktura dhe kontrolli i veprimtarisë së sistemit tretës. Funksioni motor dhe sekretor i sistemit tretës. Funksioni tretës dhe thithës i sistemit tretës.</i>	<i>fq.106-120</i>	Leksione 3 orë
	Seminar 17 - 18 – Diskutim mbi Sistemin Tretës		<i>Seminare 2 orë</i>
X.	Tema 28 – 29 - 30 – Metabolizmi i lendeve dhe energjisë <i>Metabolizmi i proteinave, karbohidrateve dhe yndyrnave. Shpejtësia metabolike dhe faktorët që e përcaktojnë atë. Rregullimi i yshqyerjes.</i>	<i>Fq.121-125</i>	Leksione 3 orë
	Seminar 19 - 20 – Diskutim mbi metabolizmin e lëndëve dhe energjisë		<i>Seminare 2 orë</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
XI.	<p>Tema 31 - 32 – Hipofiza dhe hipotalami endokrin <i>Njohja me sistemin endokrin në përgjithësi, hormone e adeno dhe neurohipofizës, faktorët çlirues dhe frenues të hipotalamit endokrin.</i></p> <p>Tema 33 – Funkzioni endokrin i pankreasit <i>Veprimet e insulinës, glukagonit, somatostatinit. Mekanizmi i veprimit dhe rregullimi i prodhimit të tyre.</i></p>	<p><i>fq.126-133</i></p> <p><i>fq.133-135</i></p>	<p>Leksione 2 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>
	<p>Seminar 21 - 22 - Diskutim mbi sistemin endokrin, sistemi hipotalam-hipofize.</p>		Seminare 2 orë
XII.	<p>Tema 34 – 35 – Funkzioni endokrin i gjëndrave mbiveshkore <i>Funksionet e glukokortikoideve, mineralokortikoideve dhe katekolaminave. Mekanizmi i veprimit dhe rregullimi i prodhimit të tyre.</i></p> <p>Tema 36 – Hormone të tiroides <i>Njohja me funksionet e hormoneve të tiroides, rregullimi i sekretimit dhe çrregullimet e funksionit të tyre.</i></p>	<p><i>fq.135-139</i></p> <p><i>fq.139-141</i></p>	<p>Leksione 2 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>
	<p>Seminare 23 - 24 – Diskutim mbi hormonet e gjëndrave mbiveshkore dhe tiroide.</p>		Seminare 2 orë
XIII.	<p>Tema 37 – 38 - Rregullimi hormonal i metabolizmit të Ca. Vitamina D. Funksionet e gjendrës paratiroide. <i>Funksionet e Ca, fosfateve dhe Mg. Vitamina D dhe roli i saj në thithjen e Ca dhe fosforit. Funksionet e hormonit paratiroid dhe kalcitoninës.</i></p> <p>Tema 39 - Funkzioni riprodhues mashkullor <i>Spermatogjeneza, hormonet seksuale mashkullore dhe puberteti mashkullor.</i></p>	<p><i>fq.141-144</i></p> <p><i>fq. 144-146</i></p>	<p>Leksione 2 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>
	<p>Seminar 25- Diskutim mbi metabolizmin e Ca, Mg dhe fosfateve. Seminar 26 – Diskutim mbi funksionin riprodhues mashkullor.</p>		Seminare 2 orë
XIV.	<p>Tema 40 – 41 - Funkzioni riprodhues femëror. <i>Njohja me ciklin menstrual, hormonet seksuale femërore, pubertetin femëror, menopauzën, placentën dhe rolin e saj.</i></p> <p>Tema 42 - Struktura e sistemit ekskretor <i>Funksionet e sistemit ekskretor, anatomia funksionale e veshkës.</i></p>	<p><i>fq.146-151</i></p> <p><i>fq. 152-154</i></p>	<p>Leksione 2 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>
	<p>Seminare 27 - 28 – Diskutime mbi funksionin riprodhues femëror.</p>		Seminare 2 orë
XV.	<p>Tema 43 -44 - 45 – Veshka dhe rregullimi i ekuilibrit të ujit dhe elektroliteve <i>Tre proceset e formimit të urinës: filtrimi, ripërthithja dhe sekretimi. Jashtëqitja e urinës, klirensi, balanca e ujit dhe elektroliteve, balanca acido-bazike.</i></p>	<p><i>fq.154-164</i></p>	<p>Leksione 3 orë</p>
	<p>Seminare 29/30 - Diskutim mbi sistemin ekskretor.</p>		Seminare 2 orë

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI:	<p>Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuar ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e leksionit dhe seminarit në orarin e përcaktuar.</p> <p>Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuar. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>
---------------------	---



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
KONTROLLI I VAZHUESHËM	Provim i pjesshem	Java7-8	1-15	30 pike	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Provim final	Fundi i semestrit	Gjithë lënda	60 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Gjate semestrit	-	10 pikë	Prezantim njohurish me gojë	Demonstrim procedure në përkujdesjen infermiere
	*Vlerësim i vazhduar - Do të realizohet prej pedagogut të seminarit për gjatë gjithë semestrit. Studentët do të demonstronjë në mënyrë periodike njohuri në fushën e fiziologjisë dhe funksionimit normal të trupit human.					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:					
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
5	6	7	8	9	10	

LITERATURA

Literatura bazë	1. "Bazat e Fiziologjisë së njeriut" Prof.Dr.LuljetaCakerri 2013 (Fakulteti i Mjekësisë - UT) ISBN:99927-842-0-2
Literatura e rekomanduar	<ul style="list-style-type: none"> o Seeley, Stephens, Tate. Anatomy & Physiology. International Edition, McGraw-Hill Companies, 2006. o Medical Physiology, 2e Updated Edition: with STUDENT CONSULT 2012 o Linda S. Costanzo Lippincott Williams & Wilkins, 2014

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Dispozita:	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregojnë interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjate procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
Vonesat	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
Sjellja profesionale e studentit	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digjitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimin, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimin, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit dhe të Fakultetit të Shëndetit Publik.
Integriteti akademik dhe e drejta e autorit	Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të ë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.